



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë-Ministarstvo Obrazovanja Nauka i Tehnologije- Ministry of Education, Science and Technology

Kabineti i Ministririt/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

| | | | | | |
|--|-----|---|-------|---------------|-------------------------------------|
| REFERENCË: | | | | | |
| PËR/ZA/TO: | | Ramush Haradinaj - Kryeministër i Republikës së Kosovës | | | |
| CC: | | Shyqiri Bytyqi - Ministër MASHT | | | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | | | | | |
| NGA/OD/FROM: | | Arbër Geci - Zëvendësministër i MASHT-it | | | |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | | Raport Pune - Dhjetor 2017 - Prill 2018 | | | |
| Nr. i zyrës: | | Lokacioni: | | Data: | |
| Br. kancelarije: | 103 | Kucni: | MASHT | Datum: | 20.04.2018 |
| Room No.: | | Extension: | | Date: | |
| PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION | | | | | <input type="checkbox"/> |
| PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL | | | | | <input type="checkbox"/> |
| PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE | | | | | <input type="checkbox"/> |
| PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS | | | | | <input type="checkbox"/> |
| A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY ËE DISCUSS | | | | | <input type="checkbox"/> |
| VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION | | | | | <input type="checkbox"/> |
| SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED | | | | | <input type="checkbox"/> |
| SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED | | | | | <input checked="" type="checkbox"/> |
| SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN | | | | | <input type="checkbox"/> |
| PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION | | | | | <input type="checkbox"/> |
| AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE | | | | | |

Raport

Dhjetor 2017 – Prill 2018

Në kuadër të përgjegjësi të mija si zëvendësministër i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, jam angazhuar në vazhdimësi për të përmbushur detyrat që më janë ndarë nga Ministri, duke qenë aktiv edhe duke kontribuar me vet iniciativë në secilën temë që MASHT ka trajtuar gjatë kësaj kohe. Gjithashtu kam zhvilluar një sërë takimesh me Rektorë, Dekanë, Profesorë e Mësimdhënës me qëllim të intensifikimit të bashkëpunimit, në funksion të avancimit të reformave dhe rritjes së cilësisë në sistemin arsimor në Kosovë. Kam zhvilluar takime të vazhdueshme me përfaqësues të organizatave studentore për të kuptuar nga afër kërkesat e tyre. Kam vizituar një numër të madh të Institucioneve Arsimore në Kosovë. Në kuadër të MASHT jam angazhuar dhe kam asistuar në punën e vazhdueshme që është bërë në avancimin e politikave në sistemin arsimor në vendin tonë.

Më poshtë janë një pjesë e aktiviteteve që kam zhvilluar gjatë kësaj periudhe:

- ❖ **Pjesëmarrje në punëtorinë dy ditore për përgatitjen e planit vjetor të punës së Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.**
 - Përfshirja e politikave të reja të Ministrit në planin vjetor të punës.
 - Rishikim i obligimeve të Ministrisë që janë bartur nga viti i kaluar në vitin pasues.

- ❖ **Shënim i 10 vjetorit të themelimit të Institutit Pedagogjik të Kosovës.**
 - MASHT e ka vlerësuar punën e Institutit Pedagogjik të Kosovës, si një nga institucionet publike me rëndësi të veçantë për avancimin cilësor të reformave në arsimin parauniversitar dhe ka thelluar bashkëpunimin me këtë Institut.

- ❖ **Pjesëmarrje në Konferencën me temën: Integritetit në Arsimin e Lartë, me theks të veçantë çështjen e Plagjiaturës nga Stafi Akademik.**
 - MASHT në partneritet me Këshillin e Evropës dhe Zyrën e BE në Kosovë, ka mbajtur në fokus të angazhimeve të veta çështjen e Integritetit Akademik në Arsimin e Lartë duke përfshirë Parimet e Kodit të Sjelljes në Projektligjin e ri për Arsimin e Lartë, i cili është në procedim.

- ❖ **Pritje për zv.ministrin e Arsimit të Republikës së Shqipërisë, në MASHT.**
 - Temë e takimit ka qenë kultivimi dhe fuqizimi i bashkëpunimit në mes të dy Ministrive respektive, në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta që janë me interes për të dyja palët dhe reformat e domosdoshme në sektorin e Arsimit me qëllim të rritjes së perspektivës për rininë tonë.
 - Bashkëpunimi në nivel të Ministrive të dy vendeve ka qenë i vazhdueshëm.

- ❖ Kam zhvilluar disa takime dhe kam bashkëpunuar ngusht me përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme në kuadër të angazhimeve të përbashkëta për të koordinuar Strategjinë Kombëtare të Luftës Kundër Përdorimit të Narkotikëve.
 - MASHT ka ndërmarr disa hapa konkret në kuadër të sistemit arsimor, për të rritur vetëdijesimin e nxënësve për pasojat negative që shkakton përdorimi i narkotikëve dhe ka ndërmarr një sërë masash për parandalimin e dukurive negative nëpër shkolla.
- ❖ Pjesëmarrje në takimin e zhvilluar në MASHT me Kryeministrin e Kosovës, z. Ramush Haradinaj.
 - Qëllimi i takimit ishte koordinimi ndërinstytucional dhe rritja e seriozitetit dhe përgjegjësisë kundrejt testit PISA.
- ❖ Pjesëmarrje në Forumin për Kërkime të Reja Shkencore për Evropën Juglindore, mbajtur në Trieste të Italisë.
 - Bashkë me Këshilltarin e Ministrit, z. Baton Dushi, me Ministren për Shkencë të Malit të Zi dhe një sërë profesorësh e përfaqësuesish politik të vendeve të rajonit, kam marrë pjesë në Forumin për Kërkime të Reja Shkencore për Evropën Juglindore, mbajtur në Trieste të Italisë.
 - Me vendim të Ministrit të Arsimit, z. Shyqiri Bytyqi, Kosova është pjesë e iniciativës së themelimit të Institutit Ndërkombëtar për Teknologji të Qëndrueshme për Evropën Juglindore.
- ❖ Takim me Presidentin e Bullgarisë, z. Rumen Radev.
 - Bashkë me përfaqësuesit e vendeve të Rajonit, në kuadër të fuqizimit të bashkëpunimit për projekte që kanë të bëjnë me avancimin e kërkimeve shkencore e teknologjike për Evropën Juglindore kemi kërkuar mbështetje nga Presidenti Bullgar i cili udhëheqë aktualisht Presidencën e Bashkimit Evropian.
- ❖ Pjesëmarrje në takimin e Komitetit Drejtues të Institutit për Teknologji të Qëndrueshme të Evropës Juglindore.
 - Avancimi i këtij instituti është në fokus të vendeve të rajonit.
- ❖ Pjesëmarrje në Ceremoninë e 48 vjetorit të themelimit të Universitetit të Prishtinës.
 - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ka avancuar bashkëpunimin me drejtuesit e Universitetit të Prishtinës, me qëllim të fuqizimit dhe avancimit të mëtejshëm të këtij Universiteti.
- ❖ Pjesëmarrje në Themelimin e Qendrës Frankofone në Prishtinë.
 - Bashkë me Rektorin, z. Marjan Dema dhe Drejtorin Regjional të Agjencisë Universitare Frankofone, z. Ketata, kemi promovuar themelimin e Qendrës Frankofone në Universitetin e Prishtinës.
 - Ministria e Arsimit ka ndërmarr veprime konkrete për zgjerimin e mundësive të mësimin të gjuhës frënge nëpër shkollat tona, në kuadër të përfshirjes në sistemin tonë arsimor.

- ❖ **Pjesëmarrje në Konferencën e përbashkët me Odën Ekonomike Amerikane për luftimin e korrupsionit në Arsimin e Lartë.**
 - Kemi zhvilluar një sërë aktivitete në kuadër të angazhimeve të përbashkëta me partnerët tanë, për luftimin e Korrupsionit në Arsimin e Lartë.
- ❖ **Takim me përfaqësuesit e organizatave studentore në Kosovë.**
 - Bashkë me Ministrin e MASHT kemi takuar përfaqësuesit e organizatave studentore me qëllim të informimit të drejt të tyre pas përjashtimit të AKA nga EQAR.
- o ❖ **Lansimi i udhëzuesit antikorrupsion për nxënës dhe mësues.**
 - MASHT në bashkëpunim me UNDP ka lansuar udhëzuesin antikorrupsion për klasët e gjashta, si akt i parandalimit të dukurive korruptive në shoqërinë tonë.
- ❖ **Ndarje e mirënjohjeve për mësues.**
 - Në fakultetin e Edukimit, me rastin e ditës së mësuesit 7 Mars, kemi ndarë mirënjohje për mësuesit e dalluar.
- * ❖ **Vizitë studimore në Danimarkë.**
 - Takim me Rektorin e Kolegjit Universitar të Kopenhagës, z. Jakobsen.
 - Shkëmbim i përvojave në fushën e edukimit, veçanërisht në procesin e përgatitjes së mësuesve të rinj.
 - Pjesëmarrje në diskutimet dy ditore për funksionimin e sistemit arsimor të Danimarkës.
- * ❖ **Vizitë studimore në Suedi.**
 - Takim me Kryetaren e Komunës së Qytetit Lulea.
 - Takim me Drejtoreshën e Arsimit të Komunës Lulea.
 - Takime të tjera me përfaqësuesit e sindikatës së Arsimit në Suedi me qëllim të shkëmbimit të eksperiencave të vlefshme për të avancuar sistemin tonë arsimor në Kosovë.
 - Pjesëmarrje në diskutimet dy ditore për funksionimin e sistemit arsimor të Suedisë.
- ❖ **Takim me përfaqësuesit e projektit “Përkrahje adoleshentëve pas mësimit të rregullt” (ASSET).**
 - Qëllimi i këtij programi është zhvillimi i shkathtësive për punësim dhe ndërmarrësi tek të rinjtë duke krijuar botëkuptim pozitiv për të ardhmen e tyre. Kjo është iniciativë pesëvjeçare që do të sjellë përfitime shkollave të mesme të larta (klasëve 10-12). Bashkërisht kemi definuar planin vjetor të punës.
 - Gjithashtu jam caktuar për të mbikëqyrur këtë projekt si përfaqësues i MASHT.
- ❖ **Takim me përfaqësuesit e organizatës studentore “Paqja Studentore”**
 - Kemi avancuar raportet e bashkëpunimit me organizatat studentore me qëllim që të kuptojmë nga afër shqetësimet dhe kërkesat e studentëve dhe tu japim zgjidhje atyre.

❖ **Takimi i Parë i Komitetit Drejtues të Programit ASSET**

- Kam udhëhequr takimin e parë me përfaqësuesit e USAID dhe të programit ASSET si dhe me zyrtarë të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Ky takim u mbajt më 29 Mars dhe u shtjelluan tema të rëndësishme për ta avancuar projektin ASSET si dhe u prezantua Plani i Punës për vitin e parë (7 Qershor, 2017- 6 Qershor, 2018).

❖ **Vizitë në shkollat e komunës së Gjakovës për procesin e Testit Ndërkombëtar PISA**

- Në kuadër të angazhimeve tona për testin PISA, kam vizituar komunën e Gjakovës dhe me këtë rast kam takuar të gjithë nxënësit që do të përfshiheshin në testin PISA për t'i inkurajuar ata që të japin maksimumin gjatë testit.
- Si pjesë e planit operativ të Komisionit për mbikëqyrjen e Testit Ndërkombëtar PISA, u zhvilluan vizita nëpër shkolla të komunës së Gjakovës ku u shpërndan broshura dhe postera për nxënës si dhe u mbajtën takime me koordinatore komunal për testin PISA si dhe me drejtorë të shkollave përkatëse. Shkollat të cilat u vizituan: Gjimnazi "Hajdar Dushi", Shmt "Nexhmedin Nixha", Shmm "Hysni Zajmi", Shme "Kadri Kusari", SHFMU "Zekeria Rexha", SHFMU "Selman Riza", SHFMU "Dëshmorët e Herecit", SHFMU "Haxhi Hoti".

❖ **Takim i komitetit drejtues të SEEIIST në Tiranë.**

- Në këtë takim është vendosur të procedohet memorandumi i bashkëpunimit për Institutin për Teknologji të Qëndrueshme për Evropën Juglindore. Ky memorandum pritet të nënshkruhet nga Kryeministrat e vendeve të Rajonit në Maj.
- Është vendosur që ky institut të orientohet në trajtimin dhe avancimin e terapisë kundër kancerit.

❖ **Hapja e katedrave të gjuhëve përkatëse.**

- Kemi filluar procesin e hapjes së Katedrës së Gjuhës Shqipe në Kroaci dhe Itali dhe katedrën e gjuhës kroate dhe italiane në Kosovë.

Me respekt,

Arbër Geci

Zëvendësministër

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë